

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA KOMUNALE NË FERIZAJ, si gjykatë e shkallës së parë penale, e përbërë nga gjyqtari Ilir Bytyqi si dhe sekretaren juridike Mimoza Shabani, në çështjen penale kundër të pandehures, D.Q. nga Ferizaji, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP.nr.491-5/14 të dt. 04.03.2015, në shqyrtimin gjyqësor publik të mbajtur me dt. 02.06.2016, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ismet Rrahmani, të demtuarit K.N. dhe të pandehures D.Q., të njejtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

E pandehura: **D.Q.** data lindjes, nga i ati T. dhe e ëma K. e gjinisë R., e martuar, ka të kryer shkollën e mesme, amvise, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetas i Republikës së Kosovës, nr. personal

Konform nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPK-së,

LIROHET NGA AKUZA

Se me datën 26.12.2013, rreth orës 21,00 në Rr. "Halim Spahiu" në Ferizaj, përkatësisht në objektin banesor, në katin e gjashtë, në bashkëkryerje me të miturën A.Q.2 nga Ferizaj, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit e që vetit t'i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, ka vjedhur një shpuese elektrike të markës "Makita" dhe një prerës elektrike të markës "Bosch", duke i shkaktuar dëme të demtuarit K.N. në vlerë prej 270 euro.

me çka kishte për të kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së.

I demtuari K.N., në shqyrtimin gjyqësor nuk shtron kërkesë pasuro juridike.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve bugetore të gjyqatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore ne Ferizaj ka sjellë për gjykim çështjen penale sipas aktauzes PP.nr.491-5/14 dt. 04.03.2015, në ngarkim të te pandehures D.Q. nga Ferizaj të akuzuar për veprën penale të vjedhjes nga neni 325 par. 1 të KPRK-së, dhe ne shqyrtimin gjyqësor deri ne fjalën perfundimtare ka propozuar qe te i shqiptoj nje sanksion penal te parapar me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështjaeshte ne juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet perparakesaj gjykate. Po kështu është ne kompetencën lëndore dhe teritoriale te kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar te pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual dhe vendi ku është kryer ose tentohet te kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me dt. 02.06.2016, në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit, lexoj aktin akuzues, dhe gjyqtari pasi që u bind se i pandehurit e ka kuptuar akuzën, konform nenit 325 par. 1 të KPPK-së, të pandehurit iu ofroj mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

E akuzuara D.Q. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë.

I dëmtuari K.N., në fjalën përfundimtare nuk iu është bashkangjitur ndjekjes penale e as nuk ka parashtruar kërkesën pasuroro juridike

Pasi qe i akuzuari nuk e ka pranuar fajsinper veprën penale sipas kësaj akuze, Gjykata ka bere paqazitjen e provave dhe pas vlersimit te tyre nje nga nje dhe duke i ndërlidhur reciprocikisht njëren me tjetern, ne kuptim te nenit 361 par. 1 dhe 2 te KPPK-së, vërtetoj gjendjen e fakteve te përshkruar hollësisht ne dispozitivin e këtij aktgjykimit:

I dëmtuari K.N., ne lidhje me kete procedim penal ka deklaruar ne shqyrtimin gjyqësor se: punoj ne firmen .&. “ ne cilsin e molerit, njekoshit banjo edhe ne kete object banesor, ditën kritike I kam takuar dy vajza te cilat nuk I kam njohur, te njejtat me kan pytur se ku banon A. (mbiemti nuk I kujtohet), ju kam treguar se nuk njoh ketu A. po ju mund ta kerkoni ne object, keto dy vajza me vete kan patur nje kесе te cilen e mbajke D.Q. ne dore, I demtuari me teper deklararon se: para baneses i kam lene nje shpuese elektrike e llojit Makita dhe nje prerse elektrike e llojit Bosch kam shkuar ne shitore dhe jame k’thyer ne banes per 10-15 min, pastaj me ka thirr ne telefon nje komshi dhe me njoftoi se kepuat e musafirve nuk i ka para deres dhe dikush I ka marr. Une nuk I kam pare se ato I kane marre ato mjete mirpo dyshoj ne to. Po ashtu epandehura pas disa Muajve me ka njoftuar se mjetet e punes ti ka vjedhe A.Q.2. Edhe pas kesaj ne kete banes me jane vjedhe disa pale kepuca pasi kemi te vendosur kamerar ne katin e pare, ne ato inxhizime eshte pare A.Q.1 dhe A.M. dhe keto inxhizime I kam dorzuar ne polici.

Deshmitarja A.Q.2, ne lidhje me kete procedim penal ka deklaruar ne shqyrtimin gjyqësor se: me kujtohet se kemi qene teke banesa2 dhe kemi hyper deri ne katin e 3 apo 4 me D.Q., aty nje djale e kam pyter per nje vajz apo djal (nuk I kujtohet sakt se kend ka lype), personi qe ishte ne objektin banesor ne tha nuk e njoh, ne kete banes vetem kemi hyre per te shiqu nese ka per te vjedhe ndonje gje, mirpo aty nuk kemi pare asgje, D.Q. ka patur me vete nje kесе te zeze, mjetet qe po me pytni I kem verejtur por aty present ka qene nje person dhe per keto as une as D.Q. si kem marr.

E pandehura D.Q., ne mbrojtjen e saj ne lidhje me kete procedim penal ka deklaruar ne shqyrtimin gjyqësor se: kemi shkuar teke banesa ne fjale se bashku me A.Q.2, kemi hyre deri ne katin e gjashte pastaj kem zbritur pa verejtur asgje, kemi takuar K.N., A.Q.2 ka bisedu me te mirpo nuk e dij se qfar, une e pranoj gabimin e bere vetem qe kam shkuar me A.Q.2 pasi e njejta me ka then rruges se kam verejtut disa mjete pune dhe do ti vjedhim, mirpo me pergjegjesi morale dhe penale deklaroj se sa ka qene me mua nuk ka munder ti mere keto sende, por me vone ka shkuar e vetme dhe I ka marre, kete vet A.Q.2 ma ka thene pas disa kohe dhe po ashtu me ka thene se ”ty ka me ta rrase kete” gjoja se une I kam marr pasi nuk I kam fole A.Q.2 per nje jave.

Me provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor publik dhe vlerësimin e tyre veç e veç dhe në lidhje me prova tjera konform nen. 387 par. 2 të KPPK-së Gjykata gjeti se nuk u provua se i pandehura D.Q. të ketë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së.

Materialet të cilat gjinden në shkresat e lëndës konstatohet se ditën kritike pa dyshim ka ndodhur vjedhja në objektin banesor .%.. i cili gjindet në rrugën “Halim Spahiu” ne Ferizaj dhe njëkohësisht dhe nga ky objekt janë marrë një shpuse eelektrike Makita dhe një perse elektrike Bosch, prone e të demtuarit K.N., dhe se nga vlerësimet e dëshmisë së të demtuarit dhe dëshmitares A.Q.1, nuk mund të konstituohen elementet objektive dhe subjektive të veprës penale në barre të pandehures.

Kjo Gjykatë çmon se provat e paraqitura nga organi i akuzës, duhet t'i nënshtrohet, në kuptim të nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPRK-se, shqyrtimit gjyqësor, duke mos i dhënë vlerë të paracaktuar. Në një proces penal organi i prokurorisë ka barrën e provës dhe detyrimin ligjor për të provuar akuzën, ndërsa e pandehura gëzon garancinë kushtetuese të prezumimit të pafajësisë.

Në rastin objekt gjykimi, gjykata vëren se nuk plotësohet standarti i të provuarit në një proces penal, standard ky, i cili imponohet pikërisht nga parimi i prezumimit të pafajësisë. Gjykata, duke i çmuar provat, e paraqitura e të administruara në gjykim, në unitet me njëra tjetrën, bazuar në nenin 361 të KPPR, i cili përcakton mënyrën e çmuarjes së provave, vlerësimin e fuqisë provuese dhe vërtetësisë së tyre në bazë të përmbajtjes së secilës dhe bindjes së brendshme të gjykatës, arrin në konkluzionin se ndryshe nga ç'pretendohet nga akuza, nuk provohet tej çdo dyshimi të bazuar që e pandehuri të ketë kryer veprën për të cilën akuzohet dhe fakti nuk perben veprë penale.

Duke u bazuar në vlerësimin e mësipërm të provave të paraqitura nga organi i akuzës në raport me përmbajtjen e veprës penale për të cilën akuzohet e pandehura, analiza e elementëve të figurës së kësaj veprë penale paraqitet si më poshtë:

v.p. nga neni 325, vjedhje: kushdo qe personit tjetër ia merr pasurin e cila vlersohet ne shumen prej 50 euro apo me shume, me qellim te pervetsimit te kunderligjshem per veti apo per personin tjetër, denohet me.....

- **Objekti i veprës penale;** veprimet e kryera nga e pandehuri, duhet ti cenojne marredheniet juridike te vendosura per te siguruar paprekshmerine e prones, e cila mbrohet me ligj.
- **Nga ana objektive,** vepra penale e konsumuar nga e pandehura, duhet te kryer me veprime aktive, duke vjedhur-pervetesuar padrejtesisht pasurine personale.
- **Nga ana subjektive,** gjykata, duhet te arrin ne perfundimin se veprimet e kryera nga e pandehura, jane kryer prej saj ne formen e dashjes direkte duke i vjedhur.
- **Subjekti,** Gjithashtu, gjykata, konstaton se mosha madhore, si dhe pergjegjshmeria e plote e te pandehurit, e ben ate te jete perpara kriterëve ligjore per te mbajtur pergjegjesi penale.

Per gjykatën nuk jane formuar plotesisht kater piakt e sipercekura (pos pikës 4), nuk eshte kontestuese se e pandeura ka qene ne objektin baneson me te mituren A.Q.2, nuk eshte kontestuese se te demtuarit i mungonin nje shpuese elektrike dhe nje prerse elektrike, vete i demtuari i ka takuar ne dajle te banes te pandehuren dhe nuk ka mundet te vertetoj se ato me vete kishin marre mjetet e punes si me lart, eshte fakto notor se mjetet e sipercekura te punes nuk jane te vogla sa e pandehuri gjate perball takimit me te demturin mund ti kete fshehur ne trup, per me teper e pandehura tregon nje fakte se kush mund te jete kryes i kesaj vepre penale.

Prandaj, sipas vlerësimit të gjykatës në rastin konkret ka per oblogim ligjor qe te provoj ne menyre te pa kontestueshme te gjitha faktet te cilat jane ne favor dhe disfavor per te akuzuaren, duke i nderlidhe edhe me prezunimin e pafajtsise dhe me parimin ”in dubio proreo” medyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve te rendesishme per qeshtjen duhet te interpretohen ne favor te te akuzuares bazuar ne kete gjykata nuk gjeti ndonje prove material qe deshmohej fajsia e te pandehures, andaj ne baze te kesaj vendosi si ne dispozitiv te katij aktgjykimi konform nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPK-së.

I dëmtuari K.N. nga Ferizaj nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike gjerë në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Nga arsyet e sipërcekura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.278/15 të dt. 02.06.2016

Sekretarja Juridike
Mimoza Shabani

Gjyqtari Individual,
Ilir BYTYQI

KËSHILLA JURIDIKE – kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.